



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 759/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Afijete Sada – Glllogjani dhe Ferki Xhaferi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Kushtrim Zuka, duke vendosur lidhur me apelin e Albana Bytyqi nga Suhareka, kandidate për deputete nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Nr.860-2021, të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet e apeluara, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET pjesërisht apeli Anr.759/2021 i datës 05.03.2021, i paraqitur nga Albana Bytyqi nga Suhareka, kandidate për deputete nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për deputet nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), në Vendvotimet: VV 1603A/01D, VV 1725C/02D, VV 3032A, VV 1724C/02R, VV 0203X, VV 0103C, VV 0106C dhe VV 0114C.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të kutive të votimeve në Vendvotimet si në pikën - II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

IV. Refuzohet pjesërisht apeli Anr.759/2021, në pjesën e apelit që ka të bëjë me vendvotimin 1214/0103D.

A R S Y E T I M

Me datë 05.03.2021, kandidatja për deputete nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Albana Bytyqi ka paraqitur në PZAP, apelin Anr.759/2021, me të cilën pretendon se në Komunën e Malishevës, Pejës, Rahovecit, Gjakovës, Deçanit etj., përkatësisht në vendvotimet 1603A/01D, 1725C/02D, 3032A, 1214/0103D, 1724C/02R, 0203X, 0103C, 0106C dhe 0114C, ka pasur shkelje dhe pa rregullsi, që kanë rezultuar në dëm të saj. Panelit i propozon që për vendvotimet e përmendura në ankesë ta urdhërojë KQZ-në të bëjë rinumërimin e tyre.

Si dëshmi për pretendimet e saj, parashtruesja e apelit ka bashkangjitur deklaratat e disa dëshmitarëve, në deklaratat e tyre pohojnë se kanë votuar kandidaten Albana Bytyqi nga

radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, si dhe kopjet e dokumenteve identifikuese të dëshmitarëve.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, me rastin e shqyrtimit të pretendimeve ankimore, provave që gjinden në shkresat e lëndëve, materialin zgjedhor dhe pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apeli është pjesërisht i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, si dhe deklaratat e dëshmitarëve ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit. Nga provat e ofruara si dëshmi nga vete pala ankuese, për vendvotimin 1603A/01D deklaratat e dëshmitarëve Shqipe Kabashi, Mejdi Kabashi, Nazim Kabashi, për vendvotimin 1725C/02D deklaratat e dëshmitarëve Fidan Berisha, Visar Gashi, Mahije Gashi, për vendvotimin 3032A deklaratat e dëshmitarëve Flamur Shala, Fanol Shala, Avni Shala dhe Imrije Shala, për vendvotimin 1724C/02R deklaratat e dëshmitarëve Ilir Gashi, Shkelzen Gashi dhe Besian Gashi, për vendvotimin 0203X deklaratën dëshmitarit Nevruz Deva, për vendvotimin 0103C deklaratat e dëshmitarëve Sahit Mataj dhe Arlind Gjocaj, për vendvotimin 0106C deklaratën e dëshmitarit Smajl Qerimaj dhe për vendvotimin 0114C deklaratën e dëshmitarit Haxhë Gjukaj, rezultojnë fakti se apeli i ushruar nga Albana Bytyqi është i bazuar sa i përket vendvotimeve të lartë shënuara.

Sa i përket pjesës refuzuese të vendimit, ku është refuzuar rinumërimi i vendvotimit 1214/0103D, paneli pas verifikimit të listës së vendvotimeve të publikuar nga KQZ-ja, konstatoi se një vendvotim i tillë me këtë numër nuk ekziston në asnjë qendër të votimeve të Kosovës, andaj si të tillë paneli e refuzoj si të pabazuar.

Andaj mbi këtë baze dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në këto vendvotime si në vijim: VV 1603A/01D, VV 1725C/02D, VV 3032A, VV 1214/0103D, VV 1724C/02R, VV 0203X, VV 0103C, VV 0106C dhe VV 0114C, rezultati i dalur nga ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të vitit 2021.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezultojnë se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 LZP urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.759/2021 më datën 06.03.2021

Kryesuesja e Panelit
Kymete Kicaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.